

VENDIM
Nr. 936, datë 26.12.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË
29.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË
SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 dhe 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohen personat e renditur në listën “a” “Lista e shtuar e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës “A” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me talibanët”, çregjistrohen personat e renditur në listën “b” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës “B” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, shtohen kompanitë e renditura në listën “c” “Lista e shtuar e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët.

4. Në fund të shkronjës “C” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “d” “Lista e shtuar e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

5. Nga lista e shkronjës “C” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen personat e renditur në listën “e” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

6. Nga lista e shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në listën “f” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si kompani të çregjistruara me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët:

1. ABDUL RAUF: ZAKIR;

b) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”:

1. TAHIS;

2. ABDUL WASAY: MU’TASIM: AGHA;

c) Lista e shtuar e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët:

1. HAQQANI NETWORK (HQN);

d) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida:

1. AYYUB: BASHIR;

2. AAMIR: ALI: CHAUDHRY;

e) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. ALI: MOHAMED: ELHEIT;

2. LOTFI: BEN ABDUL HAMID: BEN ALI: AL-RIHANI;

3. AHMED: EL BOUHALI;

4. FAZUL: ABDULLAH: MOHAMMED;

5. ABDULLAHI: HUSSEIN: KAHIE;

6. YASIN: ABDULLAH: EZZEDINE: QADI;

f) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. AL-QAIDA IN THE ARABIAN PENINSULA (AQAP).